




BANKA QENDRORE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS
CENTRALNA BANKA REPUBLIKE KOSOVO
CENTRAL BANK OF THE REPUBLIC OF KOSOVO



REGJISTRI I KREDITEVE TË KOSOVËS
REGISTAR KREDITA KOSOVA
CREDIT REGISTRY OF KOSOVO



Furnizimi i institucioneve kredidhënëse dhe kredimarrësve me informacionet e nevojshme kreditore individuale përmes sistemit të Regjistrit të Krediteve të Kosovës (RKK) është një shërbim me rëndësi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). RKK-ja është dizajnuar si një aplikacion i bazuar në internet dhe mund të qaset drejtpërdrejt dhe në kohë reale nga institucionet kredidhënëse. Në RKK, institucionet kredidhënëse fusin dhe azhurnojnë të dhënat mbi kreditet e tyre të lejuara, dhe ato mund të marrin nga RKK-ja një raport përmbledhës mbi nivelin dhe statusin e krediteve në lidhje me klientët e tyre individualë. RKK-ja është e dizajnuar po ashtu që përmes BQK-së secili person të mund të marrë detajet e veta kreditore nëse është e nevojshme. Mandej, gjithashtu shërben për mbikëqyrje të institucioneve kredidhënëse.

RKK-ja siguron një mjet me rëndësi për funksionimin e tregut kreditor. Mundëson vlerësimin më të mirë të mundësisë kredimarrëse dhe rreziqeve të personave individualë dhe, si rrjedhojë, lehtëson në masë të madhe procesin e lejimit të kreditit.

Internet: www.bqk-kos.org/crk

Email: regjistriikrediteve@bqk-kos.org

Tel: + 381 (0) 38 229 041

Faks: + 381 (0) 38 244 410

Adresa: Njësia e Regjistrit të Krediteve
Banka Qendrore e Republikës së Kosovës
Rruga Garibaldi nr. 33, 10000 Prishtinë
Republika e Kosovës



REGJISTRI I KREDITEVE TË KOSOVËS
REGISTAR KREDITA KOSOVA
CREDIT REGISTRY OF KOSOVO

Regjistri i Krediteve

Ekonomia moderne e tregut është në masë të madhe e bazuar në kredit. Regjistri i krediteve, si pjesë vitale e sistemit të krediteve, siguron informacione kreditore që mbështesin institucionet kredidhënëse në vlerësimin e mundësisë kredimarrëse të aplikuesve për kredit. Jo vetëm që ndihmon institucionet kredidhënëse për të kontrolluar borxhet e klientëve të tyre, por gjithashtu luan një rol të rëndësishëm në ngritjen e efikasitetit të procesit të lejimit të kreditit dhe lehtësimin e kredimarrjes për qytetarët dhe bizneset. Regjistri i krediteve duhet të ofrojë sigurinë dhe fshehtësinë e informacioneve përderisa lehtëson këmbimin e informacioneve ndërmjet institucioneve kredidhënëse.

Regjistri i Krediteve të Kosovës (RKK)

Regjistri i Krediteve të Kosovës (RKK) është një regjister publik i krediteve që është themeluar dhe funksionon në kuadër të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës (BQK). Ai është futur në funksion në vitin 2006 me financim të ofruar nga Banka Botërore. Veçoritë e tij kryesore janë renditur më poshtë:

- ◆ Përmban informacione aktuale mbi statusin dhe nivelin e krediteve të qytetarëve dhe bizneseve individuale.
- ◆ Raportimi i institucioneve kredidhënëse është i detyrueshëm.
- ◆ Këmbimi i informacioneve bëhet ndërmjet të gjitha institucioneve kredidhënëse.
- ◆ Është i zhvilluar si një aplikacion i sigurt i internetit me qasje të drejtpërdrejt 24 orë për tërë stafin e certifikuar të institucioneve kredidhënëse.

Akterët e RKK-së

BQK

BQK-ja përveç që menaxhon RKK-në, gjithashtu shfrytëzon RKK-në për të ushtruar rolin e vet mbikëqyrës. Stafi i BQK-së i mbikëqyrjes së institucioneve financiare përmes RKK-së ka qasje në kreditet aktive të çdo institucioni kredidhënëse. Në këtë mënyrë, RKK-ja paraqet një element të rëndësishëm të mbikëqyrjes nga jashtë të institucioneve kredidhënëse.

Institucionet Kredidhënëse

Të gjitha bankat komerciale dhe institucionet mikrofinanciare në Republikën e Kosovës janë të lidhura në RKK. Nga ato kërkohet që të fusin në sistemin e RKK-së shënimet mbi të gjitha kreditet e lejuara dhe të azhurnojnë këto shënime në mënyrë periodike. Në anën tjetër, ato mund të marrin nga RKK-ja raportet përmbledhëse kreditore lidhur me klientët e tyre.

Bankat Komerciale

PRO CREDIT BANKA	RAIFFEISSEN BANKA
BANKA PËR BIZNES	NLB PRISHTINA
BANKA EKONOMIKE	TEB BANKA
BKT-DEGA PRISHTINË	KB-DEGA MITROVICË

Institucionet Mikrofinanciare

FINCA	KEP	START NGO
KOSINVEST	KRK	BESËLIDHJA
AFK	ABU APMP	BALCANACTIE
C.E.L.I.M.	KGMAMF	PERSPEKTIVA
MESHTEKNA	ACP	KAD

Kredimarrësit

Raportet përmbledhëse kreditore të RKK-së përmbajnë informacione kreditore mbi kredimarrësit individualë. Nëse është e nevojshme, në BQK secili kredimarrës mund t'i marrë detajet e veta kreditore të regjistruara në RKK.

Informacionet e RKK-së

Të dhënat e regjistruara

Institucionet kredidhënëse i fusin në sistemin e RKK-së të dhënat personale të kredimarrësit, të dhënat mbi kreditin, të dhënat mbi kolateralin, si dhe të dhënat personale të palëve të tjera të lidhura. Këto të dhëna mund të barten elektronikisht ose të futen manualisht nga stafi i tyre i certifikuar. Gjithashtu institucionet kredidhënëse azhurnojnë statuset e krediteve të tyre dhe sipas nevojës mund të azhurnojnë të dhënat e tjera të caktuara.

Raportet

Institucionet kredidhënëse mund të marrin raportet përmbledhëse kreditore lidhur me kredimarrësit e tyre aktualë ose të mundshëm, me autorizimin e tyre. Një raport i tillë tregon jo vetëm kreditet personale të kredimarrësit por edhe çdo lidhje të kredimarrësit me kreditet e tjera të regjistruara. Në mënyrë që të mbahet fshehtësia e biznesit të tyre, institucionet kredidhënëse nuk marrin informacione mbi kushtet e krediteve ose identitetet e institucioneve kredidhënëse të cilat i kanë lejuar ato.

Kredimarrësit mund të marrin nga RKK-ja raportet e veta kreditore të detajuara. Të gjitha informacionet relevante lidhur me një kredimarrës të vetëm paraqiten në një raport të tillë. Raporti i tillë është i dizajnuar në radhë të parë për të verifikuar shënimet e diskutueshme dhe mund të merret nga kredimarrësi në ndërtesën e BQK-së.

Siguria dhe Fshehtësia

Të dhënat e regjistruara në RKK janë të siguruar sipas parimeve më të mira të pranuar ndërkombëtarisht për mbrojtjen e të dhënave. Ruajtja e fshehtësisë së çdo të dhëne të kredimarrësit zbatohet në mënyrë të rreptë. Raportet kreditore mund të merren vetëm me autorizimet e kredimarrësve individualë. Vetëm stafi i institucioneve kredidhënëse i cili posedon certifikata të avancuara mund të qaset në RKK përmes një faqeje të sigurt të internetit.